

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Puna e kësaj drejtorie ka konsistuar në zbatimin e detyrave që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) i cili ka reflektuar detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Bazuar në sa më sipër prioritetet tona në terma afatshkurtër dhe afatgjatë respektivisht janë:

- ✚ Sigurimi i kapaciteteve administrative për të zbatuar MSA;
- ✚ Progres i mëtjshëm në adoptimin e standardeve europiane dhe rritje e përpjekjeve për t'u bërë anëtar me të drejta të plota në CEN&CENELEC;
- ✚ Përmirësimi i funksionimit të DPS si Organ Kombëtar Standardesh, duke aplikuar praktikat më të mira europiane.
- ✚ Marrja e masave për të rritur ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standardeve dhe çertifikimit dhe rëndësisë së tyre në tregtinë ndërkombëtare.

Ç'farë është realizuar gjatë këtij viti:


Adoptimi i standardeve Europiane.

Adoptimi i standardeve europiane (EN) si standarde shqiptare (S SH) është në shifrat prej 2774 standardesh gjatë 2006 ose e shprehur ndryshe deri në fund të 2006 kemi të adoptuara 62.3% të numrit të përgjithshëm të standardeve europiane të të dy organizmave europiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC. Nga standardet e CEN janë adoptuar gjithsej 8960 standarde ose 74.6% e tyre dhe standarde të CENELEC janë adoptuar gjithsej 1640 ose 32.8% e tyre. Objektivi ynë ka qenë 60% deri në fund të vitit 2006.

Gjatë vitit 2006 janë adoptuar 2830 standarde gjithsej, nga të cilat:

1	standard shqiptar, S SH,
53	standarde ndërkombëtare, ISO dhe ISO/IEC
2774	standarde europiane, EN
<u>2</u>	<u>standarde të tjera</u>
2830	standarde gjithsej

Grafiku i mëposhtëm paraqet gjëndjen aktuale të arkivës së Standardeve Shqiptare dhe originën e tyre sipas llojeve:




Standarde	S SH EN	S SH	S SH ISO	Të tjera	Totali
Numri	10600	3465	1091	163	15320

Raporti i standardeve të miratuara çdo vit pëson ndryshim, në drejtim të rritjes së numrit të standardeve europiane dhe ndërkombëtare të adoptuara si standarde shqiptare.


Origjina e standardeve S SH ka një përmirësim të dukshëm. Tashmë standardet puro shqiptare zënë vetëm 24% (nga 28% në 2005) të nr. të përgjithshëm të standardeve dhe vetëm standardet e adoptuara EN (duke përfshirë këtu dhe EN dhe ISO) zënë 68% (nga 63% në 2005) të të gjitha standardeve shqiptare që kemi.

Progresi i standardeve shqiptare nga viti 1990 deri 2006, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Vitet	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
SSH gjithsej	4721	4786	4837	3823	3966	4838	5966	7038	8565	10081	12580	15320
Stand. të huaja	42	80	116	266	409	1281	2408	3479	5002	6525	9075	11860

Zhvillimi i standardeve S SH të publikuara çdo vit paraqitet si më poshtë:



Ndërsa përbërja e standardeve të huaja të adoptuara si standarde shqiptare në vitin 2006 është si më poshtë:


Standardi	ISO	EN	UN/ECE	IEC	CNR	Të tjera	Shuma
Numri	1090	10600	33	14	41	77	11860



Ritmi i adoptimit të standardeve europiane, nga viti në vit, ka rritje të dukshme (siç shihet dhe grafikisht) dhe është një nga përparësitë e punës tonë.

Gjatë këtij viti, është rritur ritmi i adoptimit të standardeve europiane elektrike dhe elektronike nga CENELEC. U adoptuan 902 standarde të CENELEC si S SH.

Vitet	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Stand. EN	82	985	1590	2425	3907	5357	7860	10600
Stand. të CENELEC	-	-	-	-	-	90	740	1642




Adoptimi i standardeve te harmonizuara


Detyrë tjetër e rëndësishme për ne, si dhe kusht për zbatimin e PKZMSA është adoptimi 100% i standardeve të harmonizuara. Standardet e harmonizuara janë ato standarde që dalin në zbatim të Direktivave të Metodës së Re (*New Approach*) që janë duke u transpozuar në legjislacionin vendas nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera. Zbatimi i këtyre standardeve nga industria siguron zbatimin e kërkesave themelore të direktivave (pra të ligjit) dhe nivel të kënaqshëm të cilësisë së produkteve vendase duke ju dhënë mundësinë për të konkuruar edhe në tregun ndërkombëtar.

Për t'i shërbyer dhe orientuar më mirë klientët, adoptimi i standardeve me listë nuk bëhet më. Sot standardet adoptohen me përkthim të faqes së parë, ndonëse në shumë raste kërkohen që standardet të jenë të përkthyer plotësisht. Mundësitë e përkthimit me fondet e DPS janë minimale për të mos thënë zero. Gjatë këtij viti u përkthyen vetëm 8 standarde me pak fonde të siguruara nga projekti CARDS 2003.

Raporti sipas mënyrës së adoptimit të standardeve të huaja, deri më 31.12.2006, paraqitet si më poshtë:



Raporti i standardeve puro shqiptare ndaj standardeve europiane të adoptuara si S SH çdo vit rritet në favor të standardeve europiane, siç paraqitet dhe në grafikun krahasues të mëposhtëm:



Gjatë këtij viti janë shfuqizuar 56 standarde puro shqiptare, të cilat konfliktojnë standardet EN në fuqi.

Këtë vit janë aktivizuar dhe funksionuan rregullisht 40 Komitete Teknike, dhe janë bërë 64 mbledhje të këtyre Komiteteve, në të cilat janë diskutuar dhe miratuar të 2830 standardet.

Në këtë aktivitet janë përfshirë mbi 100 specialistë me përvojë të fushave të ndryshme, të cilët vijnë nga sektori privat dhe shtetëror, institucione shkencore, administrata publike, dhomat e tregëtisë, shoqata prodhuesish dhe konsumatori, universitetet, etj. Këta kanë sjellë drejtë përdrejtë mendimet e palëve të ndryshme që përfaqësojnë, gjatë procesit të adoptimit të standardeve. Gjithashtu, në zbatim të parimit të punës së standardizimit – transparencë, konsensus dhe gjithëpërfshirje – shpërndahet çdo 4 muaj Buletini i DPS, i cili përmban listën e standardeve që miratohen, listën e standardeve që shfuqizohen dhe listën e standardeve për mendim publik.

Me qëllim përafrimin e metodave të punës sonë me ato të organeve të homologe të BE, tek ne ka funksionuar Grupi i Ekspertëve të Standardizimit, (i përbërë nga ekspertë teknike të fushave të ndryshme). Ky është organ këshillimor dhe jep mendimet e tij gjatë procesit të programimit të punës për adoptimin e standardeve.

Pamvarësisht nga programimi i standardeve që adoptohen, gjatë vitit është patur parasysh që të adoptohen edhe standarde të tjera që publikohen nga organizma ndërkombëtare dhe evropiane dhe që ne na duket e nevojshme të adoptohen sa më parë, në ndihmë të klientëve.

Krijimi i Bordit të DPS.

Një nga detyrat ka qenë edhe krijimi i Bordit të DPS, si një organ që do të monitorojë punën e këtij institucioni. Në bazë të PKZMSA, ne kemi hartuar projektin edhe me asistencën e projektit CARDS 2003, dhe e kemi derguar në METE për miratim.

Gjatë këtij viti gjithashtu:

- U bë një riorganizim i Komiteteve Teknike, (KT) duke bërë bashkime apo riemërtime, në mënyrë që të ketë përputhje edhe me ndryshimet e bëra në KT të CEN dhe CENELEC.
- Me qëllim përmirësimin e sistemit të cilësisë në DPS dhe përafrimin e praktikave tona me ato të organeve evropiane të standardizimit (CEN/CENELEC) janë bërë rishikime dhe saktësime të procedurave të punës, në përputhje me rregulloret e CEN/CENELEC.
- Është në përfundim database i standardeve, i cili përmban të dhëna të plota për standardet. Ky database i shërben përmirësimin të punës sonë brenda DPS duke shpërndarë informacionin e nevojshëm sektorëve të tjerë, si atij të informacionit dhe shitjes së standardeve, si dhe njëkohësisht është shumë i vlefshëm për palët e interesuara dhe për bashkëpunëtorët e DPS. Gjithashtu, përgatitja dhe publikimi i Katalogut të Standardeve Shqiptare do të jetë më i saktë dhe më i plotë.
- Në mënyrë që t'i shërbehet me cilësi klientëve tanë, standardet e vjetra shqiptare po rishtypen dhe po arkivohen elektronikisht. Këtë vit janë shtypur 322 standarde dhe në total shifra ka arritur në 670 standarde.
- Me asistencën e projektit CARDS 2003 është bërë e mundur pjesmarrja e anëtarëve dhe sekretarëve të KT të DPS në mbledhjet e KT evropiane CEN dhe CENELEC.

Gjatë këtij viti, me ndihmën e programeve CARDS (kombëtar dhe rajonal), specialistë të drejtorisë tonë, si dhe ekspertë e bashkëpunëtorë në procesin e standardizimit, kanë marrë pjesë në trajnime dhe aktivitete të ndryshme.

Gjatë këtij viti ka patur bashkëpunim të mirë me disa ministri, institucione të ndryshme shtetërore dhe private dhe projekte e shoqata, universitetet, në drejtim të hartimit dhe përmirësimit të legjislacionit, promovimit të standardeve, rishikimit të tyre, etj.

Plotësimi i 9 kushteve për t'u pranuar antarë me të drejta të plota në Organizmat Europiane të Standardizimi CEN dhe CENELEC, është një detyrim që rrjedh nga neni 75 i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Në këtë drejtim është punuar si më poshtë:

Kushti 1 – Firmosja e Marrëveshjes së Asocim-Stabilizimit. Shqipëria tani është në fazën e *Interim Agreement*;

Kushti 2 – Legjislacioni ynë për standardizimin është në përputhje me atë të vendeve anëtare. Në ligjin “Për Standardizimin” standardet janë dokumenta vullnetare. Përsa i takon zbatimit, ka ende për t'u bërë, për arsye se janë bërë pengesë disa vendime dhe rregulla teknike, të miratuara nga ministri të linjës, me anën e të cilave disa standarde, të cilët mund të jenë dhe konfliktualë me standardet europiane të CEN, bëhen të detyrueshme. Nga ana jonë po bashkëpunohet me ministrinë që kjo pengesë të hiqet. Si rezultat janë duke u rishikuar disa vendime (p.sh. VKM. Nr. 281 dt 8.5.2003 dhe VKM. Nr 646, dt 12.12.2002), dhe lista e standardeve që këto vendime u referohen, po reduktohet në mënyrë të dukshme, duke zbutur kështu barrierat teknike, drejt eliminimit të plotë të tyre. VKM Nr. 40 dt 18.01.2006 bën të mundur heqjen e disa grupe standardesh të detyrueshëm duke i kthyer në standarde vullnetare. Si rezultat, disa paragrafë të VKM Nr 646, dt 12.12.2002 janë shfuqizuar, duke e hequr detyrimin në zbatim të disa standardeve (179 standarde dhe grupe të tjera standardesh).

Kushti 3 – Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, me ligjin Nr. 8464, dt. 11.03.1999, është Organi Kombëtar i Standardizimit në Shqipëri, kompetent për të gjitha fushat që mbulon CEN dhe CENELEC, me përjashtim të standardeve të fushës së Telekomunikacionit, të cilët mbulohen nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT). Rregullat dhe mënyra si punohet në DPS, është duke u përafuar me mënyrën e organizimit të standardizimit vullnetar, siç veprohet në CEN/CENELEC. Gjatë këtij viti u rishikuan rregulloret dhe procedurat që të jenë sa më të përputhura me ato të CEN/CENELEC. Procesi i hartimit, adoptimit dhe miratimit të standardeve bëhet mbi bazën e parimeve të standardizimit ndërkombëtar – transparencë, gjithëpërfshirje, konsensus – të të gjitha palëve të interesuara në këtë proces.

Kushti 4 – Nga ana jonë, paguhet rregullisht kuota e anëtarësimit në të dy organet Europiane, ku ne kemi statusin e antarit *affiliate*.

Kushti 5 – Kemi filluar pjesmarrjen në punën formale të KT të CEN/CENELEC, për përgatitjen e standardeve. Puna në Komitetet tona Teknike është në përmirësim të vazhdueshëm, qoftë nga përzgjedhja e anëtarëve të KT, eksperiencia e fituar gjatë punës dhe trajnimeve të ndryshme të bëra me asistencën e projektit CARDS 2003.

Tashmë ekziston një listë e personave që marrin pjesë aktive në procesin e standardizimit dhe që janë kualifikuar në këtë drejtim.

Kushti 6 – Për sa i takon pjesmarrjes formale në proceset e CEN, është e nevojshme pajisja me infrastrukturë dhe telekomunikacion (përfshirë e-mail dhe internet), të cilat në sajë të programit CARDS 2001 janë siguruar dhe personeli është duke u trajnuar për përvetësim maksimal. Vetëm kështu do të mund t'i përgjigjemi vëllimit të madh të të dhënave dhe dokumentave që marrin pjesë gjatë procesit të votimit elektronik. Me shtimin e vëllimit të punës doli e nevojshme rritja e kapacitetit të serverit, gjë që është në përpunim e sipër.

Kushti 7 – Një mision tjetër i rëndësishëm është zbatimi i standardeve europiane nga operatorët ekonomikë vendas. Faza e parë, që është adoptimi i këtyre standardeve si standarde shqiptare po realizohet me ritme të kënaqshme, gjë që shihet nga vëllimi i madh i standardeve që adoptojmë. Më shumë për t'u bërë është në drejtim të shfuqizimit të standardeve kombëtare që bien ndesh me ato europiane (këtë vit u shfuqizuan 56 standarde shqiptare si dhe po bëhet një shqyrtim i vazhdueshëm për shfuqizimin e të tjerave. Për këtë, siç u tha edhe më lart, në disa raste pengohet nga legjislacioni, apo ndonjë koncept ende i vjetëruar lidhur me keto probleme.

Kushti 8- Tashmë pothuajse është pezulluar puna për hartimin e standardeve të reja shqiptare. Dy vitet e fundit nuk është bërë asnjë standard i ri puro shqiptar, por janë bërë vetëm rishikime të dy standardeve ekzistuese, në drejtim të përmirësimit dhe përafrimit me kërkesat bashkëkohore.

Kushti 9 – Ekziston ligji kombëtar për botimet, e drejta intelektuale dhe politika komerciale. Njihet dhe zbatohet Guida 10 e CEN/CENELEC më lidhje me shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve të CEN&CENELEC.


Në konformitet me rregullat për të ruajtur të drejtën e autorit standartet botohen duke shkruar në faqen e parë logon e të drejtës së autorit.

5. Duke u nisur nga prioritetet e DPS, një rëndësi e madhe i është dhënë promovimit të rëndësisë e përfitimeve që ka përdorimi i standardeve europiane nga prodhuesit vendas. Kështu, me asistencën e programit CARDS (kombëtar e rajonal) janë organizuar në Tiranë dhe në disa qytete kryesore të vendit 9 seminare informuese, përfshirë këtu edhe një aktivitet “*Open Day*” në Parkun Rinia në Tiranë në bashkëpunim me Zyrën e Mbrojtjes së Konsumatorit. Për organizimin e seminareve në qytetet e tjera kemi bashkëpunuar ngushtë me Agjensitë Rajonale të Zhvillimit në këto rrethe. Janë shpërndarë mbi 200 materiale trajnimi (tematikat e seminareve) si dhe një numër i madh materialesh të tjera informimi si broshura, fletëpalosje, libra etj. Për të rritur informacionin dhe njohjen rreth DPS dhe rolit të saj janë shpërndarë një numër i madh dosjesh, fletëpalosjesh, stilolapsa, kartolina, postera etj. Është marrë pjesë në dy ekspozita të organizuara gjatë këtij viti në Bari të Italisë dhe në Tiranë. Janë shfrytëzuar gazetatat e përditëshme me karakter kryesisht ekonomik, revistat Monitor dhe Ndërtuesi, si dhe kanalet televizive për të publikuar artikuj dhe intervista rreth standardeve dhe rolit të DPS në reduktimin e barrierave teknike në tregti.

Si rezultat, gjatë këtij viti janë shitur gjithsej **523** standarde (përkundrejt 287 standardeve në 2005) nga të cilat për këtë vit **276** standarde janë standarde Europiane (EN) përkundrejt 92 standardeve EN gjatë 2005. Nga shitja e këtyre standardeve janë krijuar të ardhura në

shumën prej **1 430 658** lekë. Muaji që ka krijuar më shumë të ardhura ka qënë Marsi me një shumë prej **447 178** lekë të ardhura. Përveç muajit Mars muajt e tjerë më të mirë kanë qënë Shtatori me një shumë prej **172 270** lekë, muaji Tetor me një shumë prej **181930** lekë, muaji Nëntor **173 936** lekë dhe muaji Dhjetor me një shumë prej **201 845** lekë. Standardet më të shitura për vitin 2006 kanë qënë **S SH EN 17025:2006, S SH EN 590:2000, dhe S SH ISO 9001:2004.**

Grafiku i mëposhtëm jep qartë që standardet EN janë shitur më shumë, krahasuar me standardet e tjera (S SH dhe ISO). Standarde Europiane (EN) **276, 160** standarde të përkasin standardeve Shqiptare (S SH) dhe **78** standarde të shitura janë standarde ndërkombëtare (ISO), kurse standardet e tjera të shitura janë në numër të vogël.



Gjatë këtij viti blerësit kanë qënë 37 nga sektori publik dhe 50 nga ai privat.

Me rëndësi të veçantë është përgatitja nga ana jonë dhe firmosja nga Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës (METE), zoti Genc Ruli, i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis METE dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administrim të Përkohshëm në Kosovë, i cili vepron për Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes (Ministritë së Tregtisë dhe Industrisë) për bashkëpunim në fushat e Standardizimit dhe Akreditimit. Kjo Marrëveshje do të pasohet nga një marrëveshje më e detajuar midis DPS dhe Agjensisë Kosovare të Standardizimit (ASK) për shkëmbim informacioni dhe shitjen e standardeve.

Është bërë rinovimi i kontratës që kemi nënshkruar me Institutin e Ndërtimit për shitjen e standardeve kryesisht të fushës së ndërtimit, por jo vetëm, si dhe nënshkrimi i një kontrate me Laboratorin Kibe 1 shpk në Durrës për shitjen e standardeve që lidhen me analizat laboratorike të materialeve që përdoren në ndërtim. E rëndësishme në këto kontrata është fakti që këto kontrata janë më favorizuese për DPS, në krahasim me kontratën e vitit 2005 me Institutin e Ndërtimit.

Grafiku dhe tabela e mëposhtëme japin hollësira në lidhje me ecurinë e shitjeve për vitin 2006 (e shprehur në lekë):

Muajt Viti 2006	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Të ardhurat	37940	11760	447178	38905	35539	59005	34510	35840	172270	181930	173936	201845






Tabela dhe grafiku i mëposhtëm japin ecurinë e të ardhurave nga shitja e standardeve krahasuar me vitin 2005, sipas muajve:

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	TOTALI
Viti 2006	37940	11760	447178	38905	35539	59005	34510	35840	172.270	181.930	173.936	201.845	1.430.658
Viti 2005	26460	47425	54690	58480	11885	43140	0	7.280	0	116.935	9.760	326.650	702.705



Numri i standardeve të shitura krahasuar në vite nga 2000 – 2006 jepet si më poshtë:



Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Shitja Standardeve	345	54	507	393	325	287	523
Shitja Standardeve EN	40	8	59	98	59	92	276

Gjendja e arkivës së Standardeve Shqiptare dhe origjina e tyre sipas llojeve është:

Standarde	S SH EN	S SH	S SH ISO	Të tjera	Totali
Numri	10600	3465	1091	163	15320

Lidhur me detyrimet që kemi si Pikë Referimi e OBT, gjatë këtij viti janë qarkulluar rregullisht të gjitha notifikimet e marra nga vendet antare të OBT, në të gjithë ministrinë dhe institucionet shtetërore, sipas përkatësisë. Më shumë notifikime të huaja kemi patur për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Gjatë këtij viti janë bërë 3 notifikime shqiptare të projekt ligjeve të ardhura nga Ministrinë e linjës dhe janë ndjekur me korrektësi të gjitha komentet e ardhura nga subjekte të ndryshme në lidhje me këto notifikime.

Gjithsej janë bërë 9 Notifikime nga të cilat 6 janë notifikime të projektakteve ligjore e nënligjore që kanë ndikim në mos krijimin e barrierave teknike në tregtinë ndërkombëtare (TBT) dhe 3 notifikime janë lidhur me projekt aktet ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me masat sanitare e fitosanitare (SPS).

Gjithashtu kemi patur disa pyetje/kërkesa nga subjekte të ndryshme të huaja të cilët interesohen për të eksportuar në vendin tonë dhe me ndihmën e institucioneve përkatëse kemi realizuar dhënien e informacioneve korrekte.

Janë përgatitur dhe shpërndarë 2 Buletinet Nr. 28 dhe Nr 29 të Standardeve të ratifikuara gjatë këtij viti nga DPS. Këto buletine përmbajnë standardet e miratuara gjatë këtij viti, projekt-standarde për mendim publik dhe standardet e shfuqizuara që konfliktojnë ato Europiane e ndërkombëtare në fuqi. Buletinet janë shpërndarë elektronikisht ministrive të

linjës, institucioneve dhe bizneseve që bashkëpunojnë me ne dhe që janë të interesura në lidhje me punën tonë. Gjithashtu buletinët janë shpërndarë edhe në *hard copy* personave të interesuar.

Një vemëndje e veçantë gjatë këtij viti i është dhënë përgatitjes së database-it të klientëve potencialë dhe të zakonshëm të DPS, i cili ka përfunduar dhe do të përdoret si për qëllime informacioni ashtu edhe për qëllime marketingu.

Gjithashtu DPS disponon për herë të parë database-in e klientëve të deritanishëm, ku evidentohen të gjitha të dhënat e blerësve të standardeve deri tani, të cilët do të mbahen në kontakte të vazhdueshme për të gjitha standardet e reja në fuqi që lidhen më fushat e tyre të aktivitetit.

Është punuar me arkivën elektronike duke hedhur standardet e reja çdo javë dhe duke hequr gjithë standardet e shfuqizuara.

Hapja e zyrës së klientit ku të gjithë mund të marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me standardet dhe ku klienti mund të futet vetë në arkivën elektronike të standardeve, është një tjetër arritje.

Faqja e internetit të DPS është ri-organizuar me link-e dhe informacion më të plotë bashkohor për klientët. Aty do të gjendet gjithë informacioni i nevojshëm rreth DPS dhe linku i duhur për të aksesuar katalogun e standardeve shqiptare, standardet S SH për mendim publik, standardet e miratuara dhe të shfuqizuara etj. Qëllimi i ri-organizimit të faqes së internetit është që kjo faqe të jetë funksionale dhe efikase, duke dhënë informim sa më të sakte dhe të shpejtë. Faqja e internetit të DPS do të plotësohet perfundimisht me të dhëna deri në fund të 2007.


Parashikuar në PKZMSA, janë dërguar për miratim projekt amendimet e ligjit “Për Standardizimin” që konsiston në ndarjen e funksioneve të çertifikimit nga ato të standardizimit si dhe VKM . 371, datë 04.08.1999 “Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit, çertifikimit dhe akreditimit”. Gjithashtu, janë dërguar për miratim 3 projekt vendime, të cilat shfuqizojnë VKM-te 382, datë 23.07.2002 “Për shkëmbimin e të dhënave në fushën e standardeve dhe rregullave teknike” si dhe VKM 242, datë 28.05.1999 “Për miratimin e kodit të përgatitjes, adoptimit, miratimit dhe zbatimit të standardeve”. Këto projekt vendime janë: transpozim i plotë direktivave 98/34/EC dhe 98/48/EC, të cilat parashikojnë rregullat e procedurat e dhënies së informacionit në fushën e standardeve, rregullave teknike, procedurave të vlerësimit të konformitetit, shërbimeve të informimit të shoqërisë, si dhe Anekseve të Barrierave Teknike në Tregti (TBT) dhe masave Sanitare e Fitosanitare (SPS) të Marrëveshjes së OBT.

Spektori i Personel Organizimit për periudhën Janar – Dhjetor 2006, ka punuar për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore si dhe detyrave të përcaktuara në Rregulloren për Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, për ndjekjen e problemeve financiare me Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Buxhetit dhe të Thesarit), mbajtjen e evidencës kontabile konform Ligjit “Për Kontabilitetin” dhe Planin Kontabël të Institucioneve Buxhetore si dhe të kontrollit të përdorimit të vlerave monetare e materiale.

Për këtë periudhë është nxjerrë e dërguar në organet përkatëse bilanci ekonomik-financiar i institucionit për 9/mujorin 2006, si dhe është përfunduar ai vjetor.

Realizimi i planit të shpenzimeve buxhetore:

Plani i buxhetit për vitin 2006 është realizuar si me poshtë:




Siç shihet nga grafiku i mësipërm, plani i shpenzimeve buxhetore në zërin e pagave është realizuar 24 % më pak se planifikimi, kjo për arsye se rritja e pagave sipas VKM nr.407, date 21.06.06, u realizua për 6/mujorin e dytë të vitit, gjithashtu edhe shperblimet nga të ardhurat sipas VKM Nr.432, datë 28.06.06 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” u pezulluan.

Përsa i përket zërave të tjerë të buxhetit kemi përputhje të planit me faktin, çka tregon se zërat e buxhetit janë planifikuar në përputhje me kërkesat faktike të institucionit.

Shpenzimet operative sipas zërave, gjatë vitit 2006, paraqiten si më poshtë:

Nr	Emërtimi
1	Telefon
2	Udhëtim e dietë
3	Seminare, Publikime profesionale
4	Kancelari
5	Karburant
6	Mirëmbajtje mjete
7	Energji elektrike, uje
8	Komisione bankare
9	Pritje përcjellje
10	Mirëmbajtje pajisjesh
11	Materiale pastrimi
12	ICC, PTT, DHL
13	Materiale zyre dhe të përgjithshme
14	Të tjera operative
15	Siguracione e taksa



Nga të dhënat e mësipërme rezulton se kemi ulje të ndjeshme në zërat e shpenzimeve operative, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në zërat: telefon, udhëtim e diete, kancelari, mirëmbajtje mjete, materiale sanitare, materiale zyre e të përgjithshme, të tjera operative, etj gjë që tregon për një administrim më të mirë të vlerave materiale, ndërkohe që kemi rritje të shpenzimeve për publikime profesionale e seminare, çka tregon për një punë më të mirë në rritjen e promovimit të rolit që DPS ka në zhvillimin e tregut të brendshëm dhe rritjen e rolit të standardeve europiane (EN), dhe veçanërisht përdorimi i tyre nga biznesi vendas për më shumë eksporte, rritje të kërkesave të konsumatorit për cilësi, që përkthehet në më shumë siguri dhe cilësi në jetën dhe shëndetin e shtetasve. Përsa u përket rritjeve të zërave të tjerë të shpenzimeve ato janë të papërfillshme, disa prej tyre kanë të bëjnë me rritjen e tarifave të shërbimeve nga të tretë, pra që nuk varet nga puna e institucionit.

Realizimi i Planit të Investimeve

Kundrejt planit të çelur nga buxheti për investime në shumën 2.000.000 lekë, nga të cilat 1.800.000 lekë nga buxheti dhe 200.000 lekë nga të ardhurat, janë kryer investime në shumën 1.924.792 lekë, ose 97 % e tyre. Investimet e realizuara paraqiten si më poshtë:

Nr.	Investimi	Shuma në lekë
1.	TVSH – detyrim doganor	291.273
2.	Pajisje zyre e informatike	512.975
3.	Rikonstruksioni i zyrave të DPS	1.120.544
Shuma		1.924.792

Realizimi i të ardhurave dytësore.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2006, janë realizuar gjithsej të ardhura në shumën 1.430.658 lekë, kundrejt planit të parashikuar prej 700.000 lekë, pra të ardhurat janë tejkaluar në shumën **730.658 leke**, ose **105% më shumë** se ato të planifikuara, ndërsa, krahasuar me

vitin 2005 janë realizuar më shumë të ardhura në shumën **501.453 lekë**, ose **154 % më shumë** se të ardhurat e realizuara në vitin 2005.

Në zbatim të VKM Nr.432, datë 28.06.06 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, u hartua Udhëzimi i përbashkët ndërmjet Ministrisë së Financave dhe DPS Nr.4, datë 02.12.06, sipas të cilit 30 % e shumës së të ardhurave të realizuara i takojnë DPS dhe janë përdorur konform udhëzimit, ndërsa diferenca prej 70% është derdhur në buxhet. Gjithashtu nga ana e DPS-s i janë propozuar Ministrisë së Financave, çmimet e reja të shitjes së standardeve dhe tarifave për shërbimet që ofron DPS, kjo në zbatim të politikave të mbështetjes dhe iniciativës së Qeverisë “Shqipëria 1 Euro” si dhe prioriteteve për rritjen e zbatimit nga ana e operatorëve ekonomike vëndas të standardeve europiane.

Raporti i të ardhurave të realizuara krahasuar me fondet buxhetore të çelura për tre vitet e fundit paraqitet:

Në lekë

Vitet	Fonde të çelura nga buxheti	Të ardhurat e realizuara	Përqindja e të ardhurave ndaj buxhetit
2004	27.256.469	526.747	1,9
2005	27.000.000	929.205	3,4
2006	27.000.000	1.430.658	6

Personeli.

Në zbatim të VKM Nr.407, date 21.06.2006 “Per miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrive të linjës”, si dhe Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, nr.588, datë 28.08.2006 “Për miratimin e strukturës organizative të DPS”, u bë ristrukturimi i organikës së DPS-s. Për këtë u pasqyruan ndryshimet përkatëse në rregulloren e DPS, u rinovuan kontratat individuale të punës së punonjëve me shtojcat përkatëse të cilat përmbajnë detyrat e secilit, si dhe u miratuan rregullorja për vlerësimin vjetor të punonjesve dhe rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave.